

VENDIM
Nr. 59, datë 29.8.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE”

(Ndryshuar me vendimin nr. 14, datë 9.3.2011; nr. 25, datë 3.5.2017; nr. 15, datë 7.2.2018; nr. 64, datë 24.11.2021; nr. 11, datë 5.2.2025)

(I përditësuar)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të nenit 53 pika 4 të shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 55, të nenit 56 pika 2, neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet udhëzimi “Mbi transparencën e operacioneve dhe shërbimeve bankare”, i miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.49, datë 22.4.1999 dhe neni 22/1 i rregullore “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.52, datë 14.7.2004.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE

MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE
(Miratuar me vendimin nr. 59.datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbi mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit për klientët mbi produktet dhe shërbimet bankare e financiare të ofruara nga subjektet e kësaj rregulloreje, me qëllim sigurimin e transparencës dhe mbrojtjen e klientit.

Neni 2
Subjektet

(Ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 5.2.2025)

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja, subjektet financiare jobanka, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike (më poshtë për thjeshtësi do t'i referohemi

me termin “banka”), të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë ligji “Për bankën”) dhe të nenit 53 pika 4, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 55, të nenit 56 pika 2, të neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për bankat”).

Neni 4 Përkufizime

(Shtuar shkronja “c” dhe “d” me vendimin nr. 14, datë 9.3.2011; shtuar togfjalësh në pikën 1 me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017; shtuar shkronja “e” dhe “f” në pikën 2 me vendimin nr. 64, datë 24.11.2021; shtuar shkronjat “g”, “h”, “i”, “j” dhe “k” në pikën 2 me vendimin nr. 11, datë 5.2.2025)

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4 të ligjit “Për bankat” dhe në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Normë efektive e interesit” (NEI) - është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje;

b) “Kostoja totale e kredisë për klientin” është tërësia e të gjitha shpenzimeve, duke përfshirë dhe interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që klienti paguan në lidhje me marrëveshjen e kredisë sipas kushteve të saj (shpenzimet për shërbimet ndihmëse për marrëveshjen e kredisë, në veçanti primet e sigurimit, përfshihen nëse shërbimi është i detyrueshëm për të përfituar kredinë ose normën e interesit të aplikuar);

c) “Normë fikse e interesit për kreditë” është norma e interesit, për të cilën banka dhe kredimarrësi bien dakord në marrëveshjen e kredisë, që të jetë një përqindje fikse e pandryshuar për gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë ose disa përqindje fikse të pandryshuara për periudha të pjesshme;

d) “Normë e ndryshueshme e interesit për kreditë” është norma e interesit, për të cilën banka dhe kredimarrësi bien dakord në momentin e nënshkrimit/lidhjes së marrëveshjes/kontratës së kredisë, e cila llogaritet mbi bazën e një indeksi orientues dhe një marzhi fiks;

e) “Indeksi orientues” - përfaqëson normat ndërbankare të ofruara të interesit, të cilat publikohen nga autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuar për administrimin e tyre dhe/ose norma të tjera interesi që kuotohen në treg në mënyrë të vazhdueshme dhe janë transparente për publikun e gjerë e që njehsohen me normat e interesit të instrumenteve të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të vendeve të ndryshme. Këto norma përfaqësojnë normat referencë që përdoren gjerësisht në çmimin e transaksioneve financiare;

f) “Klauzolë e ndryshimit të indeksit orientues” - është parashikimi kontraktor i përcaktuar në kontratën e kredisë, e cila i jep të drejtë bankës të zëvendësojë indeksin orientues, në rastet e aplikimit të interesit të përbërë, nëse ndodh një ndërprerje e kuotimit të këtij indeksi orientues për monedhën e kredisë. Kjo klauzolë aplikohet vetëm me kusht që, nga autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuar për administrimin e indeksit, të ketë një përcaktim të qartë të datës së ndërprerjes së kuotimit të indeksit orientues për monedhën dhe zëvendësimin e tij me një indeks orientues alternativ të publikuar nga këto autoritete.

Banka e Shqipërisë publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, në çdo rast, burimin e informacionit (faqen zyrtare të internetit) të autoritetit rregullator apo të autoritetit të autorizuar për administrimin e indeksit, që publikon indeksin orientues alternativ përkatës.

g) “publicitet/reklamë në media elektronike” – nënkupton publicitetin/reklamën në programet e radios dhe televizionit, si dhe në programet sipas kërkesës (on-demand), që janë të disponueshme nëpërmjet rrjeteve elektronike të komunikimit, në këmbim të pagesës;

h) “publicitet/reklamë në media të shkruar (të shtypur)” – nënkupton publicitetin/reklamën në shtypin e ditës, në revista dhe në forma të tjera të shtypura të informimit publik, si dhe në botimet e tyre në formë digjitale, të cilat janë identike me botimin e shtypur dhe janë të disponueshme për publikun sipas kërkesës, online;

i) “publicitet/reklamë në ambiente të jashtme” – nënkupton publicitetin/reklamën nëpërmjet mjeteve të përshtatshme për përcjelljen e një mesazhi promocional për publikun, të vendosur në ambiente të jashtme dhe në dispozicion për publikun dhe/ose për një numër të pacaktuar marrësish (panel reklamash, stendë, afishe, ekran, tabela ndriçuese etj.);

j) “publicitet/reklamë në ambiente të brendshme” – nënkupton përcjelljen e mesazhit reklamues nëpërmjet posterave, afisheve, paneleve, broshurave, fletushkave, fletëpalosjeve etj., të cilat janë instaluar dhe/ose shpërndarë në ambientet e brendshme të biznesit të bankës dhe partnerëve të saj të biznesit (p.sh. institucionet financiare të lidhura, tregtarët etj.) dhe/ose në hapësira të tjera të brendshme të aksesueshme nga publiku (p.sh. në qendra tregtare, aeroporte, stacione të autobusëve, mjete transporti publik etj.);

k) “publicitet/reklamë online” – nënkupton publicitetin/reklamën në faqe interneti, në rrjete sociale, aplikacione ose nëpërmjet formave të tjera të komunikimit online.

KREU II PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme

(Ndryshuar paragrafi i parë, shtuar pikat 8, 9, 10, 11 me vendimin nr. 14, datë 9.3.2011; shtuar pika 1/1, ndryshuar toffjalësh në pikën 3, ndryshuar pika 4, shfuqizuar pika 5 me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017; shtuar pika 3/1 me vendimin nr. 15, datë 7.2.2018; ndryshuar pika 9 me vendimin nr. 64, datë 24.11.2021)

1. Bankat publikojnë dukshëm dhe qartësisht në faqet e tyre të internetit dhe në ambientet e tyre të punës informacionin mbi normat e interesit të kredive dhe depozitave, si dhe komisionet për produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë për klientët.

1/1. Bankat, në rregulloret dhe procedurat e brendshme të veprimtarisë, përfshijnë ndër të tjera edhe rregullat për transparencën ndaj klientit.

2. Bankat sigurojnë që informacioni, afatet, kushtet e produkteve dhe shërbimeve, të drejtat dhe përgjegjësitë e klientit, të jenë të plota dhe të sakta, si dhe në një gjuhë të kuptueshme për klientin. Gjuha ligjore ose teknike, do të përdoret vetëm kur paraqitet e domosdoshme.

3. Përpara se klienti të zgjedhë një produkt ose shërbim, bankat i japin klientit paraprakisht informacion të plotë për kushtet, afatet dhe normat në përqindje të interesit, për rreziqet që shoqërojnë marrjen e produktit apo shërbimit, si dhe komisionet dhe penalitetet, në rastet kur këto të fundit bëhen të aplikueshme etj.

3/1. Në rastin kur klienti aplikon për një kredi në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat dhe kur banka vlerëson se kapacitetet e tij për t’u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit janë të pamjaftueshme, banka i ofron klientit, si alternativë, një kredi të krahasueshme në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat e tij.

4. Bankat, në rastet kur ndryshojnë kushtet e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare apo financiare, njoftojnë:

a) në mënyrë individuale, secilin klient që është subjekt i këtyre ndryshimeve, sipas afatit dhe formës së përcaktuar në kontratën ndërmjet palëve (me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike) dhe të dokumentuar nga banka; si dhe

b) nëpërmjet afishimit të njoftimeve ose broshurave në ambientet e bankës, në faqen zyrtare të internetit ose me mjetet e komunikimit masiv.

Ky njoftim kryhet të paktën 15 ditë përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme. Njoftimi duhet të përmbajë informacion të saktë, të plotë dhe të shprehur në një gjuhë të kuptueshme për klientin. Në çdo rast, kushtet e kontratës nuk mund të ndryshohen pa u dhënë pëlqimi i klientit sipas përcaktimeve të kontratës.

5. Shfuqizuar.

6. Bankat informojnë paraprakisht klientin, në rastin e përdorimit të kartave të debitit/*cash* dhe të kartave të kreditit, për kushtet e përdorimit dhe për komisionet e veprimeve që kryhen me kartë, në veçanti në ATM-të e bankës dhe ATM-të e bankave të tjera. Ky informacion afishohet për klientin pranë ATM-së, përveçse informimit në marrëveshjen (kontratën) e lidhur për këtë lloj shërbimi. Përmbajtja e njoftimit që do të vendoset pranë çdo ATM-je të bankës do të jetë sipas aneksit nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

7. Bankat u bëjnë të qartë klientëve të gjitha rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballen në përdorimin e çdo produkti apo shërbimi që ato ofrojnë.

8. Bankat hartojnë dhe miratojnë sipas mënyrave të parashikuara në rregulloret e tyre të brendshme metodën/politikën e llogaritjes:

a) të normave të interesave për kreditë dhe depozitat;

b) të komisioneve për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare.

9. Bankat nuk ndryshojnë, pa pëlqimin e klientit, gjatë kohëzgjatjes së kontratës/marrëveshjes së kredisë metodën/metodologjinë e llogaritjes së normës së interesit dhe/ose elementet përbërëse të saj, penalitetet në rast vonese/kamatëvonesat, si dhe çdo parashikim tjetër që e ngarkon klientin me kosto financiare, për të cilën/at është rënë dakord me klientët në momentin e lidhjes së marrëveshjes/kontratës së kredisë.

10. Banka paraqet pranë Bankës së Shqipërisë raportet në baza tremujore mbi normat e interesave për kreditë dhe depozitat dhe komisionet për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare që ajo i ofron klientëve. Këto raporte paraqiten brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të periudhës tremujore, sipas formës së raportimit të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

11. Banka e Shqipërisë publikon në mënyrë të përmblodhur dhe krahasimore normat e interesave për kreditë dhe depozitat dhe komisionet për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare të raportuara për të gjitha subjektet.

Neni 6

Metoda e llogaritjes dhe publikimi i normës efektive të interesit për kreditë

(Ndryshuar paragrafi 10 me vendimin nr. 14, datë 9.3.2011; ndryshuar togfjalësh në pikën 3, në pikën 5 me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017)

1. Norma efektive e interesit llogaritet sipas formulës matematike të paraqitur në aneksin nr.1 të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllime të llogaritjes së normës efektive të interesit, totali i koston së kredisë për klientin sipas nenit 4, pika b, nuk përfshin:

a) shpenzimet që nuk njihen në datën e llogaritjes, që mund të ndodhin gjatë disbursimit të kredisë;

b) shpenzimet e pagueshme nga klienti për moszbatimin e ndonjë prej angazhimeve të tij, të parashikuara në marrëveshjen e kredisë;

c) shpenzimet e tjera të ndryshme nga çmimi i blerjes, të cilat, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, klienti është i detyruar t'i paguajë nëse blerja është kryer me para në dorë ose me kredi me këste, me kusht që vetë banka të mos jetë përfituesi i fundit i këtyre pagesave;

d) kostot e pagueshme nga klienti, lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, një noter, autoriteti i taksave, regjistri i hipotekave) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë;

e) shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë jo të detyrueshme;

f) çdo shpenzim që do t'i paguhet bankës nga klienti vetëm kur:

v) kredia në dispozicion nuk është përdorur në tërësi ose pjesërisht;

vi) klienti kërkon një ndryshim të afateve të pagesave dhe banka e pranon një kërkesë të tillë.

3. Shpenzimet e hapjes dhe mirëmbajtjes së një llogarie apo të përdorimit të një karte ose mjeti tjetër pagese për transaksionet e livrimit të kredisë dhe pagesës, si dhe kosto të tjera lidhur me transaksionet e pagesave në përgjithësi, do të përfshihen në koston totale të kredisë për klientin, nëse hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë janë të detyrueshme për të përfituar kredinë ose për ta përfituar atë sipas kushteve të rëna dakord.

4. Norma efektive e interesit llogaritet bazuar në supozimin që marrëveshja (kontrata) e kredisë është e vlefshme për periudhën e rënë dakord dhe palët plotësojnë detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në marrëveshjen (kontratën) e kredisë.

5. Në rastin e marrëveshjeve të kredisë që përmbajnë dispozita, që lejojnë ndryshime në normat e interesit ose shpenzimet e tjera që përfshihen në normën efektive të interesit, por të pamatshme në kohën kur kjo normë llogaritet, norma efektive e interesit llogaritet duke supozuar që përqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara (fikse), në lidhje me nivelin e përcaktuar në datën e nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë.

6. Banka duhet të parashikojë në kontratën e kredisë mënyrën e njoftimit të klientit në çdo rast të ndryshimit të elementeve bazë në llogaritjen e normave efektive të interesit, përpara se të zbatojë këtë ndryshim.

7. Norma efektive e interesit publikohet duke përdorur termin “norma efektive e interesit ” ose shkurtimin “NEI”.

8. Banka publikon normën efektive të interesit në mënyrë të saktë dhe të thjeshtë në ambientet e bankës.

9. Banka paraqet pranë Bankës së Shqipërisë raporte në baza tremujore mbi normat efektive të interesit, për të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve që ajo i ofron klientëve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas përfundimit të periudhës tremujore.

10. Banka e Shqipërisë publikon të dhëna mbi normat efektive të interesit, të raportuara nga subjektet e kësaj rregulloreje, duke ruajtur sekretin e informacionit për klientin/ët.

Neni 7

Elemente të marrëveshjes (kontratës) së kredisë

(Ndryshuar paragrafi 1, shkronja “c” me vendimin nr. 14, datë 9.3.2011; shtuar togfjalësh në shkronjën “c” pika 1, në pikën 2 me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017; shtuar togfjalësh në shkronjën “d” të pikës 2 me vendimin nr. 15, datë 7.2.2018; ndryshime në nen me vendimin nr. 64, datë 24.11.2021)

1. Për çdo marrëdhënie kreditimi, banka dhe kredimarrësi nënshkruajnë një marrëveshje (kontratë) me shkrim, e cila minimalisht përfshin elementet e mëposhtme:

a) qëllimin e përdorimit të kredisë;

b) llojin e kredisë (me këste, kufi etj.);

c) kushtet e kredisë që lidhen me vlerën, njësinë monetare, datën e dhënies, datën e maturimit, normën nominale vjetore të interesit dhe llojin e saj (e ndryshueshme ose e pandryshueshme), indeksin orientues, marzhi, normën efektive të interesit, frekuencën e ndryshimit të normës së interesit apo pjesëve përbërëse të saj. Vlerën periodike të shlyerjes së kredisë (kësti), metodën e llogaritjes së kështit të kredisë dhe datat ose periudhën e shlyerjes;

d) kontributin fillestar të kredimarrësit (nëse është e zbatueshme) ose komisione të ndryshme për marrjen dhe shlyerjen e kredisë;

e) llojin e kolateralit (nëse ka);

f) detyrimet dhe penalitetet e palëve dhe rastet kur ato lindin dhe zbatohen, veçanërisht kur subjekt i tyre është kredimarrësi;

g) mënyrën e ndryshimit të kushteve të kontratës;

h) mënyrën e përfundimit të kontratës;

h) klauzolën e ndryshimit të indeksit orientues;¹

¹ Shtuar me vendimin nr. 64, datë 24.11.2021

i) numrin e kopjeve të nënshkruara në original të kontratës dhe mënyrën e disponimit të tyre nga palët.

2. Në procesin e livrimit të kredisë për herë të parë ose në momentin e ristrukturimit të saj, banka i vë në dispozicion kredimarrësit dhe përfshin në dosjen e kredisë, një kopje të firmosur të këtij informacioni:

a) planin e shlyerjeve të kredisë në momentin e livrimit të saj dhe në rast ristrukturimi, sipas informacionit që disponohet në atë moment;

b) planin e të gjitha pagesave të paracaktuara dhe të njohura, që kredimarrësi paguan në procesin e marrjes së kredisë dhe gjatë kohëvazhdimet të saj;

c) penalitetet që zbatohen ndaj kredimarrësit dhe shembuj të metodës së llogaritjes së tyre;

d) një koment të shkruar, të shoqëruar me një shembull ilustrues, ku i tërhiqet vëmendja kredimarrësit për rrezikun që paraqet për të:

- huamarrja në valutë, veçanërisht në rastin kur të ardhurat e tij janë në lekë dhe mund të ketë lëvizje të pafavorshme të kursit të këmbimit lekë/valutë (ose e kundërta);

- rritja e normës së interesit të kredisë gjatë kohëvazhdimet të saj, si rezultat i rritjes së indeksit orientues.

3. Në rastin e kredisë për konsum, përfshirë dhe kreditë për kartat e kreditit, ose në çdo formë tjetër kreditimi, në të cilin detyrimi i klientit ndaj bankës lind në formë automatike, kushtet e dhënies, të përdorimit dhe të kthimit të kredisë, së bashku me penalitetet përkatëse, duhet të shprehen në mënyrë të plotë në kontratën që lidhet me kredimarrësin.

Neni 8

Informacione të veçanta lidhur me marrëveshjet (kontratat) e kredisë

(Ndryshuar pika 1 paragrafi i parë, shfuqizuar paragrafi i dytë me vendimin nr. 14, datë 9.3.2011; shtuar fjalë, ndryshuar togfjalësba me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017)

1. Banka, në rast të aplikimit të një norme të ndryshueshme interesi, i siguron kredimarrësit, sipas formës së përcaktuar në kontratën ndërmjet palëve (me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike), të paktën një herë në 12 muaj, informacionin e mëposhtëm:

a) normën vjetore të interesit në fillim dhe në fund të periudhës përkatëse;

b) pjesën e papaguar të kredisë në fillim dhe në fund të periudhës përkatëse;

c) shumën e çdo kësti kredie, të përcaktuar sipas një plani pagesash dhe kohën kur duhet të paguhet çdo këst, bazuar në normën vjetore të interesit, të aplikuar në fund të periudhës përkatëse.

2. Shfuqizuar.

3. Banka, në rastin e marrëveshjeve të financimit (linjave të kredisë), i siguron me shkrim kredimarrësit informacionin e mëposhtëm:

a) kufirin fillestar të kredisë, nëse është i njohur në momentin e dhënies së informacionit;

b) normën vjetore të interesit ose metodën e llogaritjes nëse është e ndryshueshme;

c) llojin dhe shumën e çdo pagese të ndryshme nga interesat;

d) pagesën minimale, gjatë çdo periudhe pagesash si dhe metodën e llogaritjes së saj;

e) çdo periudhë për të cilën do të jepet një gjendje e llogarisë;

f) datën kur dhe pas së cilës llogariten interesat dhe informacioni, në lidhje me çdo periudhë faljesh të aplikueshme;

g) të dhëna për komisionet dhe penalitetet;

h) pasurin/të e luajtshme apo të paluajtshme, nëse ka, mbi të cilën/at banka siguron kredinë.

4. Bankat, në rastin e lëshimit të kartave të kreditit, përveç informacionit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të këtij neni, japin dhe informacionin e mëposhtëm:

a) shfuqizuar;

b) datën kur dhe pas të cilës, përlllogariten interesat dhe informacion në lidhje me çdo periudhë faljesh të aplikueshme;

c) nëse kredimarrësit i kërkohet në marrëveshjen e kredisë të paguajë të gjithë pjesën e pashlyer të kredisë me marrjen e gjendjes së llogarisë, atij i jepet:

- i) përshkrimi i këtij detyrimi;
 - ii) periudha e faljes, në fund të së cilës kredimarrësi duhet të paguajë pjesën e pashlyer të kredisë;
- dhe
- iii) norma vjetore e interesit të aplikueshëm mbi pjesën e pashlyer të kredisë, dhe metoda e llogaritjes së shumës që detyrohet të paguajë klienti.
- d) Banka, në rast se merr një njoftim nga kredimarrësi, në formë të shkruar apo dhe gojore, për një kartë krediti të humbur apo të vjedhur, nuk krijon detyrimin për kredimarrësin që ai të paguajë për transaksione të kryera me kartën e tij pas, bërjes së njoftimit.

Neni 9

Elemente të kontratës së llogarisë dhe depozitës

(Ndryshuar në përmbajtje me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017)

1. Për çdo llogari dhe depozitë të hapur nga klienti pranë bankës nënshkruhet një kontratë nga palët pjesëmarrëse në transaksion. Kontrata është një akt i veçantë, i ndryshëm nga dokumentet e aplikimit për hapjen e llogarisë.

2. Në kontratën e llogarive rrjedhëse dhe të kursimit, përveç të dhënave personale të klientit dhe numrit të llogarisë, përfshihen detyrimisht:

- a) norma e interesit;
- b) metoda e llogaritjes dhe frekuenca e pagesave të interesit;
- c) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat personale nga interesat;
- d) komisionet për mirëmbajtjen e llogarive;
- e) komisione apo penalitete të tjera të aplikueshme;
- f) kriteret/kushtet për klasifikimin e llogarive në statusin “jo aktive” dhe kostot financiare të rikthimit të tyre në statusin “aktive”.

Elementet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” përfshihen në kontratë në rastet kur banka aplikon interes për llogarinë rrjedhëse dhe/ose llogarinë e kursimit.

3. Në kontratën e depozitave me afat, përveç të dhënave personale të klientit, përfshihen:

- a) shuma e investuar në depozitën me afat;
- b) norma vjetore e interesit;
- c) shuma e interesit, metoda e llogaritjes dhe frekuenca e pagesës së saj;
- d) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga interesi;
- e) data e maturimit të depozitës;
- f) kushtet e zgjedhura nga klienti për rinovimin e depozitës me afat;
- g) kushtet e zgjidhjes para afatit të përfundimit të kontratës; dhe
- h) penalitetet e aplikueshme në rastin e zgjidhjes para afatit të përfundimit të kontratës.

4. Banka duhet të parashikojë në kontratën e llogarisë rrjedhëse dhe të kursimit, mënyrën e njoftimit të klientit për ndryshimin e kushteve të kontratës së nënshkruar, para se të aplikojë ndryshimin.

5. Shfuqizuar.

Neni 10

Marketingu

(Shfuqizuar me vendimin nr. 11, datë 5.2.2025)

Neni 11

Konfidencialiteti

(ndryshuar fjalë në pikën 2 me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017)

1. Bankat ruajnë konfidencialitetin dhe/ose sekretin për të gjithë informacionin personal të klientit duke i garantuar këtij të fundit ruajtjen dhe administrimin e informacionit personal në sisteme të sigurta dhe të besueshme informacioni apo pagesash (transaksione, shërbime etj.).

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur:

a) banka detyrohet ta japë informacionin personal të klientit sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;

b) klienti kërkon me shkrim publikimin e këtij informacioni ose banka disponon lejen/autorizimin e tij me shkrim, për këtë qëllim.

3. Bankat i japin klientit, sipas kërkesës së tij, të gjithë informacionin e evidentuar për të.

4. Bankat janë të detyruara t'i japin klientit informacion bazë mbi depozitat e tij, të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Neni 12

Ankesat e klientëve

(Ndryshuar me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017)

1. Banka harton procedura dhe rregulla të brendshme për trajtimin e ankesave të klientëve, duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen e tyre.

2. Banka i siguron klientit informacionin e nevojshëm mbi procedurat për trajtimin e ankesave në mënyrë të shpejtë dhe të plotë.

3. Në rastin e një ankese me shkrim nga klienti, banka duhet t'i japë përgjigje me shkrim klientit mbi ankesën, brenda afatit kohor të përcaktuar në aktet e brendshme rregullative të bankës ose në kontratën përkatëse ndërmjet klientit dhe bankës.

4. Banka evidenton në një regjistër të veçantë, të dhëna për çdo ankesë të klientëve që ka lidhje me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, informacion mbi zgjidhjen e këtyre ankesave, si dhe të dhëna të tjera plotësuese të nevojshme.

5. Struktura përgjegjëse për trajtimin e ankesave të klientëve përgatit në baza periodike një raport përmbledhës për organet drejtuese të bankës, mbi numrin, tipologjinë dhe zgjidhjet e ankesave të paraqitura nga klientët e bankës.

KREU III

MARKETINGU DHE PUBLICITETI I PRODUKTEVE E SHËRBIMEVE PËR KONSUMATORËT

(Shtuar kreu me nenet 12/1-12/7, me vendimin nr. 11, datë 5.2.2025)

Neni 12/1

Përmbajtja e publicitetit/reklamës apo materialeve promociionale

1. Banka siguron që çdo komunikim në formën e publicitetit/reklamës apo materialeve promociionale në lidhje me produktet apo shërbimet që do të ofrojnë:

a) të jetë i qartë, i saktë, i vërtetë, i përditësuar;

b) të jetë në gjuhën shqipe dhe i shprehur në një gjuhë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, për të mos lejuar keqinterpretimet;

c) të sqarojë kushtet kryesore të ofrimit të produkteve dhe/ose shërbimeve, si dhe të drejtat/përfitimet, detyrimet apo rreziqet që lidhen me këto produkte ose shërbime;

d) të mos përfshijë informacion të pasaktë, që çon në përfundime të gabuara, apo që zmadhon së tepërmi, ose përpiqet të fshehë veçori të produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

2. Publiciteti/reklama apo materialet promociionale duhet të përmbajnë të paktën informacionin standard të parashikuar në këtë krye, sipas llojit të produktit apo shërbimit që do të ofrohet.

3. Në rastin e promovimit të karakteristikave preferenciale ose përjashtimore të produkteve/shërbimeve (për shembull, normat e interesit ose segmenti i klientelës), banka në të njëjtin

publicitet/reklamë informon dhe mbi kushtet e veçanta që duhen plotësuar për ta përfituar këtë produkt/shërbim.

4. Informacioni i përdorur për promocionin e produkteve dhe të shërbimeve bazohet në të dhëna të sakta, të verifikueshme, të hollësishme, në përputhje me parimin e mirëbesimit dhe të praktikave më të mira të konkurrencës së ndershme dhe etikës profesionale, me qëllim që t'i komunikojë publikut një informacion objektiv, të mjaftueshëm e të paanshëm.

Neni 12/2

Format/kanalet e publicitetit dhe reklamimit të materialeve promocionale

1. Banka mund të bëjë publicitetin apo reklamimin e materialeve promocionale, por pa u kufizuar, në një ose disa nga format e mëposhtme:

- a) broshura;
- b) publicitet në shtypin e ditës, revista, radio, televizione, rrjete sociale ose faqe interneti;
- c) materiale promocionale të dërguara me postë të zakonshme ose elektronike, faks ose mjete të tjera;
- d) telemarketing, i cili përfshin përdorimin e një ofruesi të specializuar të shërbimit telemarketing, në bazë të një kontrate të lidhur me bankën;
- e) materiale apo mjete të tjera promocionale, që mund të lexohen, shihen apo dorëzohen/dërgohen te publiku.

2. Banka siguron që materialet promocionale në formë të shkruar, të paraqesin një mesazh të lexueshëm dhe të kuptueshëm për publikun.

3. Madhësia e tekstit të mesazhit promocional të transmetuar nëpërmjet medias elektronike ose online, si dhe të mesazhit promocional të publikuar në median e shkruar dhe të shpërndarë nëpërmjet publicitetit/reklamës në ambiente të brendshme ose të jashtme, duhet të jetë e tillë që të lexohet lehtësisht nga publiku, duke respektuar kërkesat e parashikuara në aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

4. Banka siguron që për format e publicitetit nëpërmjet medias elektronike, mesazhi i materialit promocional duhet të zgjatë për një kohë të mjaftueshme, për të krijuar mundësinë që publiku ta lexojë dhe/ose dëgjojë përmbajtjen e mesazhit.

5. Banka siguron që për format e publicitetit online, mesazhi i materialit promocional nëpërmjet imazheve/figurave me ose pa zë, duhet të zgjatë për një kohë të mjaftueshme, për të krijuar mundësinë që publiku ta lexojë dhe/ose dëgjojë përmbajtjen e mesazhit.

Neni 12/3

Informacioni standard në publicitetin/reklamat ose materialet promocionale për kreditë konsumatore

1. Banka, në publicitetin/reklamat ose materialet promocionale për kreditë konsumatore, përfshin një paralajmërim të qartë dhe të dukshëm, për të ndërgjegjësuar konsumatorin se huamarrja kushton para, duke përdorur formulimin “Kujdes! Huamarrja e parave kushton para” ose një formulim të ngjashëm me të.

2. Banka, në çdo publicitet/reklamë ose material promocional për kreditë konsumatore, që tregon një normë interesi ose çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, duhet të përfshijë informacionin standard të përcaktuar në këtë nen.

3. Kërkesat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, nuk do të zbatohen në rastet kur banka tregon apo paraqet në publicitet/reklamë ose material promocional, normën efektive të interesit të përlllogaritur sipas kërkesave rregullative të Bankës së Shqipërisë, e cila nuk tregon apo paraqet një normë interesi ose

çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, në kuptim të pikës 2 të këtij neni.

4. Informacioni standard i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm ose qartësisht i dëgjueshëm, sipas rastit, dhe të përshtatet me kufizimet teknike të mjetit të përdorur për reklamim, si dhe duhet të specifikojë, në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme të gjitha elementet e mëposhtme:

- a) emrin e plotë të bankës, faqen zyrtare të internetit dhe numrin e telefonit;
- b) normën e interesit të kredisë, fikse ose variabël ose të dyja, së bashku me të dhënat mbi çdo komision apo tarifë të përfshirë në koston totale të kredisë për konsumatorin;
- c) vlerën totale të kredisë, siç përcaktohet në nenin 5, pika 2, shkronja “m” të rregullores “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”;
- d) normën efektive të interesit, e cila duhet të përfshihet në publicitet/reklamë në mënyrë aq të dukshme sa edhe norma e interesit të kredisë;
- e) ku është e aplikueshme, kohëzgjatjen e kontratës së kredisë;
- f) në rastin e një kredie në formën e një pagese të shtyrë, për një mall ose shërbim të veçantë, çmimin në para dhe shumën e çdo paradhënieje;
- g) ku është e aplikueshme, shumën totale të pagueshme nga konsumatori dhe vlerën e kësteve, të përshtatur sipas vlerës totale të kredisë të parashikuar në shkronjën “c” të kësaj pike.

5. Banka, vetëm në rastet e publicitetit online që ka një përmbajtje të formës së shkurtuar, mund të mos përfshijë në mesazhin promociional disa informacione të nevojshme të parashikuara në pikat 4 dhe 7 të këtij neni, por mesazhi duhet të përmbajë një lidhje (link) direkte me faqen e internetit të bankës, që përmban informacionin e papërfshirë në mesazh. Të dhënat për faqen e internetit të bankës duhet të jenë të dukshme, në mesazhin promociional.

6. Në raste specifike dhe të justifikuara kur mjeti/kanali i përdorur për të reklamuar informacionin standard të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, nuk lejon që informacioni të shfaqet vizualisht në mënyrë të dukshme dhe të qartë, shkronjat “f” dhe “g” të asaj pike nuk do të zbatohen. Në rastin e një mjeti/kanali elektronik të përdorur për të reklamuar informacionin standard, konsumatori duhet të jetë në gjendje të aksesojë informacionin e parashikuar në shkronjat “f” dhe “g” të pikës 4 të këtij neni, nëpërmjet klikimit, lëvizjes (scrolling) ose rrëshqitjes (swiping).

7. Në rastet kur lidhja e një kontrate për një shërbim ndihmës të lidhur me kontratën e kredisë është e detyrueshme për të marrë kredinë ose për ta përfutur atë sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, dhe kostoja e atij shërbimi nuk mund të përcaktohet paraprakisht, informacioni standard i referuar në pikën 4 të këtij neni, duhet të specifikojë në mënyrë të qartë, koncize dhe të dukshme detyrimin për ta lidhur atë kontratë.

Neni 12/4

Informacioni standard në publicitetin/reklamë ose materialet promociionale për kreditë hipotekare

1. Banka, në çdo publicitet/reklamë ose material promociional për kreditë hipotekare, që tregon një normë interesi ose çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, duhet të përfshijë informacionin standard të përcaktuar në këtë nen.

2. Kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk do të zbatohen në rastet kur banka tregon apo paraqet në publicitet/reklamë ose material promociional, normën efektive të interesit të përllogaritur sipas kërkesave rregullative të Bankës së Shqipërisë, e cila nuk tregon apo paraqet një normë interesi ose çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

3. Informacioni standard i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm ose qartësisht i dëgjueshëm, sipas rastit, dhe të përshtatet me kufizimet teknike të mjetit të përdorur për reklamim, si dhe duhet të specifikojë, në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme të gjitha elementet e mëposhtme:

- a) emrin e plotë të bankës, faqen zyrtare të internetit dhe numrin e telefonit;

- b) normën e interesit të kredisë, fikse ose variabël ose të dyja, së bashku me të dhënat mbi çdo komision apo tarifë të përfshirë në koston totale të kredisë për kredimarrësin;
 - c) vlerën totale të kredisë, siç përcaktohet në nenin 5, pika 2, shkronja “m” të rregullores “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”;
 - d) normën efektive të interesit, e cila duhet të përfshihet në publicitet/reklamë në mënyrë aq të dukshme sa edhe norma e interesit të kredisë;
 - e) kohëzgjatjen e kontratës së kredisë;
 - f) shumën totale të pagueshme nga konsumatori;
 - g) vlerën e kësteve, të përshtatur sipas vlerës totale të kredisë të parashikuar në shkronjën “c” të kësaj pike;
 - h) një paralajmërim në lidhje me pasojat e mundshme të luhatjes së kursit të këmbimit, në shumën e pagueshme nga kredimarrësi (nëse është e aplikueshme);
 - i) garancitë/siguritë e nevojshme, në formën e një hipoteke mbi një pasuri ose të një garancie tjetër.
4. Banka, vetëm në rastet e publicitetit online që ka një përmbajtje të formës së shkurtuar, mund të mos përfshijë në mesazhin promociional disa informacione të nevojshme të parashikuara në pikat 3 dhe 5 të këtij neni, por mesazhi duhet të përmbajë një lidhje (link) direkte me faqen e internetit të bankës, që përmban informacionin e papërfshirë në mesazh. Të dhënat për faqen e internetit të bankës duhet të jenë të dukshme, në mesazhin promociional.
5. Në rastet kur lidhja e një kontrate për një shërbim ndihmës, në veçanti një kontrate sigurimi, është e detyrueshme për të marrë kredinë ose për ta përfituar atë sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, dhe kostoja e atij shërbimi nuk mund të përcaktohet paraprakisht, detyrimi për ta lidhur atë kontratë duhet të specifikohet në mënyrë të qartë, koncize dhe të dukshme, së bashku me normën efektive të interesit.

Neni 12/5

Informacioni standard në publicitetin/reklamat ose materialet promociionale për depozitat

1. Banka, në publicitetin/reklamat ose materialet promociionale për depozitat, përfshin informacionin standard, i cili duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm ose qartësisht i dëgjueshëm, sipas rastit, dhe të përshtatet me kufizimet teknike të mjetit të përdorur për reklamim, si dhe duhet të specifikojë, në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme të gjitha elementet e mëposhtme:
- a) emrin e plotë të bankës, faqen zyrtare të internetit dhe numrin e telefonit;
 - b) normën vjetore të interesit të depozitës;
 - c) normën e interesit mesatar ose normat përkatëse, nëse aplikohet më shumë se një normë interesi gjatë afatit të depozitës;
 - d) afatin e depozitës;
 - e) penalitetet e aplikueshme në rastin e zgjidhjes para afatit të përfundimit të kontratës.
2. Banka, vetëm në rastet e publicitetit online që ka një përmbajtje të formës së shkurtuar, mund të mos përfshijë në mesazhin promociional disa informacione të nevojshme të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, por mesazhi duhet të përmbajë një lidhje (link) direkte me faqen e internetit të bankës, që përmban informacionin e papërfshirë në mesazh. Të dhënat për faqen e internetit të bankës duhet të jenë të dukshme, në mesazhin promociional.

Neni 12/6

Ndalimi/ndërprerja e publicitetit/reklamës apo materialeve promociionale

1. Departamenti i Mbikëqyrjes urdhëron bankën të ndalojë/ndërpresë ose të korrigjojë publicitetin/reklamën apo materialet promociionale, nëse konstaton se përmbajtja e tyre bie në kundërshtim me kërkesat e këtij kreu.
2. Bankat nuk lejohen të reklamojnë produkte apo shërbime që:
- a) përmbajnë vlerësime ose parashikime në lidhje me ecurinë e ardhshme të bankës;

b) përmbajnë krahasime ndërmjet bankave të ndryshme që ofrojnë të njëjtat produkte apo shërbime, që vënë në disavantazh banka të tjera;

c) përmbajnë shprehje si “rezultat i garantuar”, “banka më e mirë”, “kosto më e ulët në treg”, “kosto zero”, “tarifa zero”, “komisione zero”, “interes zero”, “pa interes”, “më e lartë/më e ulët/më e mira në treg”, “ne ju rimbursojmë”, “ne paguajmë për ju”, “ofertë”, “dhuratë”, “miratim i garantuar” etj., ose çdo formulim tjetër që mund të krijojë përshtypjen për fitime/rezultate të sigurta apo për kosto të ulëta.

3. Përjashtimisht nga sa parashikohet në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni, banka mund të përdorë në publicitet/reklamë apo materialet promocionale, shprehjet e mëposhtme, vetëm nëse plotësohen kushtet përkatëse, si vijon:

a) “pa interes”, “interes zero”, ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur nuk paguhet interes nga konsumatori dhe nëse të gjitha kushtet e kontratës së kredisë ose shërbimeve të tjera financiare dhe të gjitha tarifat dhe komisionet (ku në këtë rast norma efektive e interesit nuk është 0%), të paraqiten në mënyrë të dukshme në publicitet/reklamë;

b) “kosto zero”, “tarifa zero”, “komisione zero” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur nuk paguhet interesa, komisione ose tarifa të tjera nga konsumatori dhe nëse marrja e një kredie ose shërbimi tjetër financiar, nuk është e kushtëzuar nga lidhja e një marrëveshjeje tjetër ose që krijon tarifa, komisione ose detyrime të tjera për konsumatorin;

c) “miratim i garantuar” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur marrja e një kredie ose shërbimi tjetër financiar nuk është e kushtëzuar nga përmbushja e kërkesave të lidhura me aftësinë paguese ose kërkesave të tjera;

d) “ofertë”, “dhuratë” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur nuk ka kushte ose rrethana që kërkojnë që konsumatori të kompensojë ose të kthejë përfitimin që i është vënë në dispozicion, për shkak të lidhjes së marrëveshjes së kredisë ose të një shërbimi tjetër financiar;

e) “ne ju rimbursojmë” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur fondet e paguara nga konsumatori do të rimbursohen plotësisht nga banka;

f) “ne paguajmë për ju” ose shprehje të ngjashme, vetëm nëse banka përballon plotësisht kostot ose nëse banka përballon një pjesë të kostove, me kusht që pjesa përkatëse e mbuluar nga konsumatori të paraqitet në mënyrë të dukshme në publicitet/reklamë;

g) “kostoja më e ulët në treg”, “më e lartë/më e ulët/më e mira në treg”, “kushtet më të mira në treg” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur paraqiten në mënyrë të dukshme në publicitet/reklamë, edhe kushtet e veçanta të kredisë apo shërbimit financiar që vërtetojnë apo që qëndrojnë në bazë të këtyre shprehjeve.

4. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, bankat nuk lejohen të reklamojnë produkte të kredisë konsumatore që:

a) inkurajojnë konsumatorët të kërkojnë kredi, duke sugjeruar se kredia do të përmirësonte gjendjen financiare të këtyre konsumatorëve;

b) specifikojnë se shumat e papaguara (tepricat) të kredisë kanë pak ose aspak ndikim në vlerësimin e një aplikimi të ri për kredi;

c) sugjerojnë në mënyrë të rreme se kredia çon në një rritje të burimeve financiare, përbën një zëvendësues për kursimet ose mund të rrisë standardet e jetesës së një konsumatori;

d) theksojnë lehtësinë ose shpejtësinë me të cilën mund të merret kredia;

e) deklarojnë se një zbritje është e kushtëzuar me marrjen e kredisë;

f) ofrojnë periudha “grace” më shumë se tre muaj për shlyerjen e kësteve të kredisë.

Neni 12/7

Ruajtja e publicitetit/reklamës apo materialeve promocionale

1. Banka ruan për 5 vite nga data e publikimit, një kopje të publicitetit/reklamës apo materialeve promocionale.

2. Banka ruan të dhënat për të gjitha publicitetet/reklamat apo materialet promocionale, duke përfshirë:

- a) një dokument në format elektronik;
- b) datën e miratimit të publicitetit/reklamës apo materialit promocional për publikim;
- c) kanalën/vendin ku është publikuar publiciteti/reklama apo materiali promocional.

3. Të dhënat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni i vihen në dispozicion Bankës së Shqipërisë me kërkesën e saj, ose gjatë inspektimeve në vend.

KREU IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE
(Rinumërtuar kreu me vendimin nr. 11, datë 5.2.2025)

Neni 13
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore
(Ndryshuar me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017)

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të parashikuara në ligjin “Për Bankat” dhe në aktet e tjera nënligjore, në zbatim të tij.”.

j) Në Aneksin 1, përmbajtja e seksionit “Metoda e llogaritjes së normës efektive të interesit për kredinë”, ndryshon si më poshtë vijon, si dhe shtohet seksioni “Disa supozime shtesë mbi llogaritjen e NEI-t”, sipas përmbajtjes së aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 14
Të fundit
(Ndryshuar titulli dhe shtuar pika 3 me vendimin nr. 64, datë 24.11.2021)

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk do të zbatohen për kreditë dhe/ose depozitat ndërbankare.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kreditë e miratuara dhe/ose depozitat e pranuar, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Klauzola e ndryshimit të indeksit orientues nuk zbatohet për marrëveshjet e kredive të miratuara, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, me përjashtim të rasteve kur banka merr masat e nevojshme për përfshirjen, me miratimin e kredimarrësit, të klauzolës së ndryshimit të indeksit orientues në marrëveshjet e kredive të lidhura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

ANEKS NR.1

METODA E LLOGARITJES SË NORMËS EFEKTIVE TË INTERESIT PËR KREDINË

(Ndryshuar me vendimin nr. 25, datë 3.5.2017)

Ekuacioni bazë, për llogaritjen e normës efektive të interesit (NEI), barazon, mbi një bazë vjetore,

nga

njëra anë vlerën totale aktuale të kredisë (total present value of drawdowns), duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj.), të vënë në dispozicion të klientit, sipas marrëveshjes

së kredisë dhe në anën tjetër, vlerën totale aktuale të shlyerjeve dhe/ose pagesave të shpenzimeve (total present value of repayments and payments of charges):

$$\sum_{k=1}^m K_k (1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-tl}$$

Kuptimi i shkronjave dhe simboleve:

i (NEI) – është norma efektive e interesit, e cila mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) kur termat e tjerë në ekuacion janë të njohur nga kontrata ose ndryshe.

m - është numri total i kësteve të lëvrimit të kredisë, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste (drawdowns), të paguar nga kredidhënësi.

k - është kësti i k-të i kredisë i lëvruar nga kredidhënësi (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste), kështu që $1 \leq k \leq m$.

K_k - është vlera e këstit të kredisë (drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (të lëvruar) në periudhën k.

tk - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të këstit të parë të kredisë (first drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kësti pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë $t_1 = 0$.

m' - është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve.

l - është pagesa e l-të e kryer nga klienti për shlyerjen e kredisë ose pagesën e shpenzimeve.

R_l - është vlera e këstit të shlyerjes ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l.

tl - intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të këstit të parë të kredisë të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) ose datës së lëvrimit të kredisë (në rast se lëvrimi i kredisë bëhet i plotë) dhe datës së çdo kësti për shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese që paguan klienti.

Shënime:

a) Shumat e paguara nga të dyja palët në kohë të ndryshme nuk është e nevojshme të jenë të barabarta dhe të paguhet në intervale të barabarta.

b) Data e fillimit duhet të jetë ajo e lëvrimit të këstit të parë të kredisë nga banka, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste ose e datës së lëvrimit të kredisë, në rast të lëvrimit të plotë të kredisë.

c) Intervalet midis datave të përdorura në llogaritje duhet të shprehen në vite ose fraksione të vitit. Një vit presupozohet të ketë 365 ditë ose 366 ditë për vitet e brishtë, 52 javë ose 12 muaj. Një muaj presupozohet të ketë 30,41666 ditë ($365/12$), pavarësisht nëse është ose jo vit i brishtë.

Nëse intervalet midis datave të përdorura në llogaritje, nuk mund të shprehen si një numër i plotë javësh, muajsh ose vitesh, intervalet duhen të shprehen si një numër i plotë i këtyre periudhave i kombinuar edhe me një numër ditësh.

Kur përdoren ditët:

i) çdo ditë përfshihet në llogaritje, përfshirë edhe ditët e fundjavës apo të pushimit;

ii) periudhat e barabarta dhe më tej, ditët duhet të llogariten në rend zbritës deri në datën e lëvrimit të parë;

iii) kohëzgjatja e periudhës duhet të llogaritet duke përfshirë ditën e parë dhe duke përfshirë ditën e fundit dhe do të shprehet në vite, duke e pjesëtuar këtë periudhë me numrin e ditëve (365 ose 366 ditë) të një viti të plotë, të llogaritura në rend zbritës nga dita e fundit, deri në të njëjtën ditë të vitit të mëparshëm.

d) Rezultatet e llogaritjes duhet të shprehen me një saktësi, të paktën një shifër pas presjes dhjetore.

e) Ekuacioni mund të rishkruhet duke përdorur një shumë të vetme në rast të lëvrimit të plotë të kredisë nga banka:

$$S = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-tl}$$

S - është vlera totale aktuale e kredisë (total present value of drawdowns), duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj).

Bankat duhet të sigurojnë që metodat e zgjidhjes së aplikueshme të japin një rezultat të barabartë me atë të shembujve të paraqitur në këtë aneks (shih më poshtë).

Disa supozime shtesë mbi llogaritjen e NEI-t

1. Nëse një kontratë kredie i jep të drejtën klientit për të tërhequr fondet në çdo kohë, do të supozohet që vlera e kredisë tërhiqet menjëherë dhe në total.
2. Nëse një kontratë kredie parashikon mënyra të ndryshme tërheqjeje nëpërmjet aplikimit të komisioneve dhe normave të ndryshme të interesit, do të supozohet që vlera totale e kredisë tërhiqet me komisionin më të madh dhe me normën më të lartë të interesit të zbatueshme për formën më të zakonshme të tërheqjes të këtij lloji kontrate kredie.

3. Nëse një kontratë kredie i jep klientit të drejtën e tërheqjes në përgjithësi të fondeve, por vendos, midis mënyrave të ndryshme të tërheqjes, një kufizim për shumën dhe periudhën kohore, do të supozohet që shumën e kredisë tërhiqet në datën më të hershme të parashikuar në marrëveshje dhe në përputhje me kufirin e tërheqjeve.

4. Nëse në kontratë parashikohen komisione dhe norma të ndryshme interesi për një shumë ose periudhë të caktuar, si normë interesi dhe komision për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë, do të konsiderohet norma dhe komisioni më i lartë i parashikuar.

5. Në kontratat e kredisë për të cilat është vendosur një normë fikse interesi në lidhje me periudhën fillestare, në fund të së cilës është vendosur një normë e re huamarrjeje dhe që më pas ndryshohet periodikisht sipas një indeksi orientues të rënë dakord, llogaritja e NEI-t do të bazohet në supozimin që, në fund të periudhës me normë fikse interesi, norma e interesit do të jetë e njëjtë si në momentin e llogaritjes së NEI-t, bazuar në vlerat e indekseve orientuese të rëna dakord në atë moment, por nuk mund të jetë më e ulët se norma fikse e interesit.

6. Nëse në një kontratë kredie (për kredinë kufi ose kartat e kreditit) nuk është përcaktuar kufiri i saj, do të supozohet që ky kufi është 200,000 lekë ose kundërvlefë në monedhë të huaj.

7. Në rastin e kontratës për kredi kufi (overdraft), do të supozohet që kredia është tërhequr në total dhe për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës së kredisë. Nëse nuk dihet kohëzgjatja e kontratës së kredisë kufi, NEI do të llogaritet duke supozuar që kohëzgjatja e kredisë është tre muaj.

8. Nëse nuk ka një plan fiks pagesash, do të supozohet që:

- a) kredia jepet për një periudhë njëvjeçare; dhe/ose
- b) kredia do të paguhet me 12 këste të barabarta mujore.

9. Nëse ka një plan fiks pagesash për shlyerjet, por shumën e pagesave është e ndryshueshme, do të supozohet që shumën e secilës pagesë është më e vogla nga vlerat që parashikon kontrata.

10. Me përjashtim të rasteve në të cilat është përcaktuar ndryshe, kur kontrata e kredisë parashikon më shumë se një datë shlyerjeje, do të supozohet që kredia bëhet e disponueshme dhe pagesat kryhen në datën më të hershme të parashikuar në kontratë.

ANEKSI NR.2

NJOFTIM PËR KOMISIONET E SHËRBIMIT ME KARTË

Klientë, kujdes!

1. Kjo ATM është e vendosur nga banka _____.

2. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në *cash*, duke përdorur kartën e debitit (_____) të lëshuar nga banka jonë. Për këtë shërbim ju paguani një komision _____.

3. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në *cash* duke përdorur kartën e kreditit (_____) të lëshuar nga banka jonë. Për këtë shërbim ju paguani një komision prej _____.

4. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në *cash* edhe me karta të lëshuara nga banka të tjera, por në këto raste ju do të paguani edhe një komision për transaksionin që banka jonë do të kryejë me bankën, që ju ka lëshuar kartën.

5. Banka jonë nuk mban asnjë përgjegjësi dhe nuk rimbursen komisionet që ju do të paguani për shërbimet e ofruara në këtë ATM, me karta të bankave të lëshuara nga banka të tjera.

6. Banka jonë është gjithnjë në shërbimin tuaj.
7. Për çdo problem dhe informacion të nevojshëm, lutem kontaktoni bankën tonë me këtë numër telefoni _____.

ANEKS NR. 3
MADHËSIA MINIMALE E SHKRIMIT PËR T'U PËRDORUR NË MESAZHIN E
PUBLICITETIT/REKLAMËS APO MATERIALIT PROMOCIONAL
(Shtuar me vendimin nr. 11, datë 5.2.2025)

<i>Publiciteti/reklama e paraqitur në:</i>	<i>Madhësia minimale e shkrimit</i>
<i>Media elektronike</i>	<i>12 pt</i>
<i>Media të shkruar dhe online</i>	<i>9 pt</i>
<i>Ambiente të brendshme në formën e broshurave, fletushkave, fletëpalosjeve etj.</i>	<i>11 pt</i>
<i>Ambiente të brendshme në formën e posterave, afisheve, paneleve etj.</i>	<i>25 pt</i>
<i>Ambiente të jashtme, me madhësi mesatare, në formën e paneleve të reklamave, stendave, afisheve, ekraneve etj. (për shembull, llojet Opi/Mupi dhe Master)</i>	<i>85 pt</i>
<i>Ambiente të jashtme, në formën e paneleve të reklamave, stendave, afisheve, ekraneve etj., në format të madh, me përmasa të tilla si 4x3 m, 5x2.4 m, 8x3 m ose 10x5 m</i>	<i>Madhësia e shkrimit duhet të zmadhohet në mënyrë të tillë që të ruhet proporcioni që rezulton nga madhësia minimale e shkrimit e përcaktuar për kategoritë e mësipërme.</i>